



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 8      Datë 29-1-2026

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE  
PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Ekzekutivi, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjin 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, VKM nr. 325/2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, si dhe VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave për krijimin e fondit publik të banesave sociale në vlerën 26,000,000 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e tij për ndërtimin e banesave sociale, me këtë strukturë buxhetore:  
SHTOHET    Prog. AI122    00    Prod. P066AAK    05    Art. 2310000    +26,000,000 lekë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Pro 28

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-1-2026

